



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.157, datë 13.11.2020

PËR

NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 28, DATË 24.03.2020, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR KRIJIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NDAJ BIZNESIT DHE SHTYRJEN E AFATEVE TË APLIKIMIT PËR PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT NË KUADËR TË MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-19”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr. 158 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, Urdhrin 156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, Aktit Normativ nr.3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid -19” dhe Aktit Normativ Nr.4 date 16.03.2020 “Për disa shtesa të Aktit Normativ Nr.3 datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid -19”, vendimin nr. 28 datë 24.03.2020 “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në Vendimin nr. 28, datë 24.03.2020, të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 2.2 ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:
“2.2. Përjashtimin nga pagesa e tarifës së pastrimit proporcionalisht për një periudhë 8 mujore dhe taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore për një periudhë 10 mujore për kategoritë e subjekteve sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Pas pikës 2.2 shtohen pikat 2.3 dhe 2.4 me përmbajtje si më poshtë:
“2.3. Uljen e detyrimit të lindur për vitin 2020 me 30% të vlerës për taksën e ndërtesës për ato subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e hotelerisë;
2.4. Përfshirjen nga pagesa e tarifës së pastrimit dhe taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore proporcionalisht për një periudhë 10 mujore për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e agjencive turistike”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

ZV/K R Y E T A R

ROMINA KUKO

Shtojca 1

Transport pasagjerësh

- Automjet deri 5 vende
- Automjet 6-9 vende
- Automjet 10-25 vende
- Automjet 26-42 vende
- Automjet mbi 42 vende